



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 12 Shkurt 2022

Nr: 74

V E N D I M

P Ë R

**MIRATIMIN E PËRMBAJTJES SË FLETËVE TË VOTIMIT PËR ZGJEDHJET E
PJESHME PËR KRYETAR BASHKIË TË DATËS 6 MARS 2022**

Në mbështetje të Dekretit nr. 13 438, datë 20.01.2022 të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore”, të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 98 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 16, datë 10.02.2022 të Komisionit Rregullator, “Për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore në fletën e votimit për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”

V Ë R E N:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13 438, datë 20.01.2022, ka caktuar datën 6 Mars 2022, për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie, në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë.

Në përfundim të afatit për regjistrimin e kandidatëve për kryetar bashkie në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, janë regjistruar gjithsej 1 (një) koalicion zgjedhor, koalicioni “Shtëpia e Lirisë” me shkronja nistore (SH-L) dhe 3 (tre) parti politike, “Partia Socialiste e Shqipërisë” me shkronja nistore (PS), “Partia Demokratike” me shkronja nistore (PD) dhe Partia “Lëvizja e Re” me shkronja nistore (LRE).



Data: 12 Shkurt 2022

Nr. 74

“Për miratimin e përmbajtjes së fletëve të votimit për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”

Pas përfundimit të procesit të regjistrimit të kandidatëve për kryetar bashkie, për zgjedhjet e pjesshme të datës 6 Mars 2022, sipas përcaktimeve të nenit 98, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve organizoi hedhjen e shortit për detyrimet që rrjedhin nga ky nen.

Me vendimin nr. 73, datë 12.02.2022, “Për miratimin e rezultatit të shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore në fletën e votimit për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miratoi rezultatit të shortit duke përcaktuar numrin rendor që do të ketë çdo subjekt zgjedhor në fletën e votimit.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, dhe 98 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimin nr. 16, datë 10.02.2022, të Komisionit Rregullator, “Për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore në fletën e votimit për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”

V E N D O S I:

1. Miratimin e fletëve të votimit për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, me përmbajtje sipas shtojcave respektive për çdo bashki, në formatin portret, duke përshtatur sipas numrit të kandidatëve, madhësinë e fontit dhe stilizimet e logove, si më poshtë vijon:
 - a) Përmbajtja e fletës së votimit për bashkinë Shkodër, është sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
 - b) Përmbajtja e fletës së votimit për bashkinë Dibër, është sipas lidhjes 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
 - c) Përmbajtja e fletës së votimit për bashkinë Durrës, është sipas lidhjes 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
 - d) Përmbajtja e fletës së votimit për bashkinë Vorë, është sipas lidhjes 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
 - e) Përmbajtja e fletës së votimit për bashkinë Rrogozhinë, është sipas lidhjes 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi;



- f) Përmbajtja e fletës së votimit për bashkinë Lushnjë, është sipas lidhjes 6, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



FLETË VOTIMI

Zgjedhjet për kryetarin e bashkisë, 6 Mars 2022

Bashkia Shkodër

Zgjidh kandidatin

| | | | |
|---|---|---|--------------------------|
| 1 |  | MAJLINDA ANGONI "Partia Socialiste e Shqipërisë" (PS) | <input type="checkbox"/> |
| 2 |  | BARDH SPAHIA Koalicioni "Shtëpia e Lirisë" (SH-L) | <input type="checkbox"/> |
| 3 |  | XHEMAL BUSHATI "Partia Demokratike" (PD) | <input type="checkbox"/> |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



FLETË VOTIMI

Zgjedhjet për kryetarin e bashkisë, 6 Mars 2022

Bashkia Dibër

Zgjidh kandidatin

| | | | |
|---|---|--|--|
| 1 |  | PREMTIM KRYEMADHI Koalicioni "Shtëpia e Lirisë" (SH-L) | |
| 2 |  | LUAN HAKA "Partia Demokratike" (PD) | |
| 3 |  | RAHIM SPAHIU "Partia Socialiste e Shqipërisë" (PS) | |
| 4 |  | DRITAN TORBA Partia "Lëvizja e Re" (LRE) | |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



FLETË VOTIMI

Zgjedhjet për kryetarin e bashkisë, 6 Mars 2022

Bashkia Durrës

Zgjidh kandidatin

| | | | |
|---|--|--|--------------------------|
| 1 | | ARDIAN MUKA Koalicioni "Shtëpia e Lirisë" (SH-L) | <input type="checkbox"/> |
|---|--|--|--------------------------|

| | | | |
|---|--|---|--------------------------|
| 2 | | EMIRIANA SAKO "Partia Socialiste e Shqipërisë" (PS) | <input type="checkbox"/> |
|---|--|---|--------------------------|

| | | | |
|---|--|---|--------------------------|
| 3 | | LUAN HOTI "Partia Demokratike" (PD) | <input type="checkbox"/> |
|---|--|---|--------------------------|



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



FLETË VOTIMI

Zgjedhjet për kryetarin e bashkisë, 6 Mars 2022

Bashkia Vorë

Zgjidh kandidatin

1



LULZIM VRANA

Koalicioni "Shtëpia e Lirisë" (SH-L)

2



BLERIM SHERA

"Partia Socialiste e Shqipërisë" (PS)

3



YMER MARKU

"Partia Demokratike" (PD)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



FLETË VOTIMI

Zgjedhjet për kryetarin e bashkisë, 6 Mars 2022

Bashkia Rrogozhinë

Zgjidh kandidatin

1



FERDINAND SARAÇI

"Partia Demokratike" (PD)

2



EDISON MEMOLLA

"Partia Socialiste e Shqipërisë" (PS)

3



HEKURAN XHANI

Koalicioni "Shtëpia e Lirisë" (SH-L)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



FLETË VOTIMI

Zgjedhjet për kryetarin e bashkisë, 6 Mars 2022

Bashkia Lushnjë

Zgjidh kandidatin

| | | | |
|---|---|---|--------------------------|
| 1 |  | ERISELDA SEFA "Partia Socialiste e Shqipërisë" (PS) | <input type="checkbox"/> |
| 2 |  | INDRIT SEFA "Partia Demokratike" (PD) | <input type="checkbox"/> |
| 3 |  | ELTON BANO Koalicioni "Shtëpia e Lirisë" (SH-L) | <input type="checkbox"/> |